



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr 7883 Prot

Gjirokastër më 10 : 09:2024

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së datës 04.09 .2024

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 04.09 .2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në 04 .09.2024 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet te mediateka pranë Universitetit “Eqrem Çabej”.

Marrin pjesë në mbledhje 19 anëtarë. Mungojnë në mbledhje: Feruni, E.Shehaj, Aliko, Mahmutaj, Rova, Drasa, Leskaj, Koçollari, M. Shehaj, Peta, Guçe, Hila

Hapet mbledhja nga Znj.Isaraj ne orën 12: 08. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës.

1.Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.07.2024.

2.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-31.08. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-31.08. 2024”.

4.P/Vendim “Për një shtesë ne VKB nr. 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024”.

5.P/Vendim” Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (sot ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit”.

6.P/ Vendim “Për miratimin e Dokumentit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”.

7.Raport i Drejtorisë së Arsimit për masat e marra për fillimin e Vitit Shkollor 2024-2025 në institucionet arsimore në varësi të Bashkisë Gjirokastër.

8.Të ndryshme.

Kalohet te diskutimi I futjes ne rendin e ditës të kërkesës së Shoqatës së Hotelerisë të bizneseve të Zonës Muzeale

z. Brahimi, të mos futet në rendin e ditës port ë trajtohet te pika të ndryshme në fund të mbledhjes.

Nuk më duket fare i drejtë shqetësimi i tyre, të trajtohen si çdo situatë tjetër

Znj. Isaraj: Bizneset i kemi aleatë dhe mendoj t’ i futim në rendin e ditës për të dëgjuar edhe shqetësimin e tyre, pasi kanë paraqitur një kërkesë për të marrë fjalën.

Pas diskutimeve miratohet rendi I dites edhe me futjen në të të kërkesës më sipër me 18 vota pro.

Z. Brahimi: Sygjerim , për Kryesinë e mbledhjes, mbledhjet të fillojnë në orarin e caktuar, pasi të mos gjendemi si herën e kaluar.



Z;Logo: Të merren masa dhe propozoj mbajtjen e pagës për mungesat në mbledhje.

ZNJ. Isaraj: Shqetësimi juaj është i drejtë . Do fillojmë me mospagimin e honorarit.

Hidhet në votë dhe miratohet me 18 vota pro procesverballi i mbledhjes së datës 31.07,2024.

Znj. Isaraj paraqet pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës .

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-30.08. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-30.08. 2024”, të cilat miratohen me 18vota pro.

Hidhet në votë dhe miratohet me 18 vota pro “P/Vendim “Për një shtesë ne VKB nr. 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024”.

Znj.Isaraj: Kalojmë te pika 5 e cila ka dy emra dhe do kalohet me dy vendime të ndryshme:

P/Vendim” Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u rregjistruar në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (sot ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit”. Për dy persona, znj, Doloreza Hamit Goxhaj dhe Z.Bonev Zako.

Materiali ka kaluar në komision.

Zjn. Cacaj: Komisioni ka shqyrtuar materialin dhe konstatoi se ishin të gjitha dokumentat e duhura për këtë procedure, e cila ju vjen ne ndihmë qytetarëve dhe u shpreh dakort për kalimin e mat në mbledhjen e sotme.

Miratohet me 18 vota pro” Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u rregjistruar në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (sot ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit”. Për dy persona, znj, Doloreza Hamit Goxhaj dhe Z.Bonev Zako.

Në orën 12: 16 min vjen në mbledhje z. Qeli.

Kalohet te pika 6 e rendit të ditës P/ Vendim “Për miratimin e Dokumentit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”.Materiali ka kaluar në Komisionin e Financave.

Znj. Koko: Ky material është procedurë standard e cila bazohet në VKM. NR.23, Nuk ka ndryshime te të ardhurat, por është vetëm shtesa nga fondet e trashëguara nga viti 2023 të cilat janë të papërdorura ose për projektet e papërfunduara të cilat i janë bashkuar këtij dokumenti.

Hidhet në votë dhe miratohet me 19 vota pro pika 6 e rendit të ditës.

Kalohet te kërkesa e ardhur nga Shoqata e Hoteleve të zonës muzeale.

Z. Bineri shpreh shqetësimin e hoteleve në zonën muzeale për rreth 60 subjekte të licensuara ku janë punësuar rreth 500 persona , paguajne sipas rregullave taksat dhe detyrimet. Nuk jemi dakord me vendosjen e taksës me kapacitet të plotë të shtretërv për 4 muaj, nuk e kemi te vlera, por te rregullat e pabarabarta, kur ka subjekteqë nuk paguajnë taksa , nuk janë të licensuara.

Ne jemi gati për një dakortësi për këtë gjë, prandaj dhe nuk kemi kryer ende pagesën për shtrat.

Z. Golemi: Të gjithjë jemi koshientë për rritjen e turizmit dhe vitin e kaluar është deklaruar nga bizneset se rreth 10 mijë turistë kanë fjetur në Gjirokastrë, por janë derdhur 1/10e shumës. Deri tani 20 mijë turistë, 30 mijë viti I kaluar . Taksa është 70 lekë për shtrat, bashkitë e tjera e kanë 2 deri tre herë më lart se ne, dhe me rritjen e turizmit janë rritur dhe shërbimet për pastrim, ndriçim, aktivitete që sjellin nr të lartë turistësh në Pazar. Ne i mbështesim bizneset dhe i shohim si aleatë, port ë flenë 100 mijë dhe të mblidhen të ardhura për 20 mijë duhet të skuqemi të gjithë.

Bashkisë i janë shtuar shpenzimet me pastrimin dhe gjithë aktivitetet që bëjnë, të cilat kanë kosto.Për datat 6,7,8 s ka dhoma se kemi telefonuar dhe s ka dhoma të lira. Jam shumë dakord me ju që të shtrijmë fashën taksapaguesve për subjektet që s’ kanë paguar deri tani .



Z.Bineri: Shqetësimi më i madh se janë hapur rreth 430 njësi dhe 60 -70 hotele paguajnë , janë hapur shtëpi çdo 20 m

Z.Golemi: Jemi gjithmonë në terren dhe po shtojmë fashën e bizneseve të licensuara, dhe fashen për 4 muaj e vendosëm që të shmangim kontaktin me punonjësit.

Z. Qeli: për 5 vjet ju lamë pa pagesa. 4 muaj s keni ju xhiro.

Z. Novi: Për 100 ditë I keni plot , paguajini por për ata që s paguajnë të zbatohet ligji.

Z. GOLEMI: Fasha është 4 muaj dhe e ndarë sipas zonave

Z. Brahimi Që pazari është këtu ku është është puna e bashkisë dhe qeverisë dhe për vitin e ardhshëm do propozoj që të rritet 2 e tre fish. Nuk jam dakord me kërkesën. Të paguajnë se ashtu marrin shërbime nga bashkia.

Kalohet te Raporti I Drejtorisë së Arsimit për masat e marra për fillimin e vitit shkollor 2024-2025.

Z. Ylli Muho bën një panoramë të punëve të kryera dhe planin për javën në vazhdim për të patur një gadishmëri të IA.

z. Golemi: Kemi ende shumë punë për të bërë me IA , por do vazhdohet me ndërhyrjen në shkollën “ Muhamet Gjollësja” . Kemi aplikuar me projekte për 4 shkollat dhe shpresojmë për 2 prej tyre si fillim. Në dy kopshte dhe në terrene sportive .Buxhetin e ardhshëm do planifikojmë më shumë fonde për arsimin.

ZNJ Cacaj : Nëse kjo mbledhje do të ishte zhvilluar më parë do kish verejtje dhe fjala ime do ishte ndryshe, por jam puna filloi dhe ju falenderoj për mbështetjen që jepni për arsimin, sepse çdo investim I kthehet qytetit.

ZNJ. Çabeli; Po për shkollën “Feim Ibrahim” a ekziston mundësia për ambiente shtesë?

Z. Brahimi: Për kopshtet e fshatit , nuk duhet të kenë varësi nga drejtuesit e shkollave , sepse është jashtë kompetencës së tyre.

Znj. Isaraj : Falënderon drejtorin për masat e marra dhe raportin e paraqitur.

Z.Golemi: Bën një paraqitje të masave të marra dhe planeve për investime në sport dhe shkolla.

Mbyllet mbledhja nga znj Isaraj në orën 13:10 .

Sekretar
Etleva YZO

KRYETAR I KËSHILLIT



Merita ISARAJ